

## 206 MATERIALET HARTOGRAFIKE – TË DHËNA MATEMATIKORE

Fusha përmban të dhëna për shkallën, projeksionet, koordinatat dhe ekuinoksin të materialet hartografike. Fusha është në përputhje me zonën e të dhënave matematikore në ISBD(CM). Fusha është e detyrueshme për materialet hartografike.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
206	Materialet hartografike – të dhëna matematikore	r
<b>a</b>	<i>Të dhënat matematikore</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 206a Të dhënat matematikore

Të dhënat për shkallën, projeksionet, koordinatat, ekuinoksin dhe epokat, përfshirë shenjat e pikësimit sipas standardit ISBD(CM).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha nuk është e ndarë në nënfusha, sepse nuk përdoret për kërkim, por për shfaqjen e të dhënave sipas ISBD-së. Udhëzimet për formën e të dhënave dhe shenjat e pikësimit ndodhen në ISBD(CM). Ndërmjet të dhënave të veçanta duhet të vendosen të gjitha shenjat e përcaktuara të pikësimit. Të dhënat në fushën 206 duhet të përshtaten me të dhënat e koduara në fushat 120, 122 dhe 123 (shih shembujt 3, 4, 5, 6, 7).

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 120 *MATERIALET HARTOGRAFIKE - TË DHËNA TË PËRGJITHSHME*

Fusha përmban të dhëna të koduara për përshkrimin e përgjithshëm të materialit hartografik.

### 122 *PERIUDHA KOHORE E PËRMBAJTJES SË NJËSISË*

Përmban të dhënat për periudhën kohore të cilës i referohet njësia. Te regjistrimet për hartat qiellore përfshinë të dhënat nga ekuinoksi.

## 123 MATERIALET HARTOGRAFIKE – SHKALLA DHE KOORDINATAT

Fusha përmban të dhëna të koduara për shkallën dhe koordinatat.

### SHEMBUJ

1.

206	□□	<b>a</b> Scale 1:250 000. Vertical scale 1:125 000 ; Universal Transverse Mercator proj. (W 124°-W 122°/N 58°-N 57°) <i>(Hartë relievi me shkallë horizontale 1 : 250 000 dhe shkallë vertikale 1 : 125000 me projeksion të Mercator; kjo mbulon pjesën e Kanadasë me gjatësi gjeografike përëndimore midis 124° dhe 122° dhe gjerësi gjeografike veriore 58°dhe 57°.)</i>
-----	----	---

2.

206	□□	<b>a</b> (RA 16 hr. 30 min. to 19 hr. 30 min./Decl. -16° to -49°; eq. 1950, epoch 1948) <i>(Hartë qiellore me ngritje të djathtë nga 16 orë e 30 minuta deri 19 orë e 30 minuta, pjerrësi nga -16°deri -49°, ekuinoks 1950, epoka 1948.)</i>
-----	----	---

3. \*

120	□□	<b>ab by cy da dg faa ebi</b>
123	1□	<b>aa b25000</b>
200	1□	<b>a</b> Državna topografska karta Republike Slovenije 1:25.000 <b>b</b> Kartografsko gradivo
206	□□	<b>a</b> 1:25.000 ; Gauß-Krügerjeva proj. <i>(Hartë topografike e Sllovenisë me shkallë lineare 1 : 25000 dhe projeksion Gauß-Krüger. Të dhënat e projeksionit në nënfushën 120e dhe shkalla në nënfushën 123b duhet të korrespondojnë me të dhënat në nënfushën 206a. Nëse shkalla gjendet në titull, ajo duhet të shënohet edhe në fushën 206.)</i>

4. \*

123	4□	<b>aa b4000</b>
206	□□	<b>a</b> [Ca 1:4.000] <i>(Kur shkalla nuk gjendet në botim, ajo mund të llogaritet nga kataloguesi dhe të vendoset brenda kllapave katrorë. Treguesi në fushën 123 duhet të ketë vlerën "4" që tregon një shkallë të përafërt.)</i>

5. \*

123	2□	<b>aa b40000 b13000 b7500</b>
206	□□	<b>a</b> 1:40.000, 1:13.000, 1:7.500 <i>(Atlas me tri shkallë të ndryshme. Vlera "2" e treguesit në fushën 123 tregon disa shkallë. Në fushën 123 shënohen vlerat e shkallëve.)</i>

6. \* COBISS.net

123	2□	<b>aa b300000 b650000 b12500 b930000</b>
206	□□	<b>a</b> [Shkallë të ndryshme] <i>(Atlas me më shumë se tre shkallë të ndryshme. Në vend të të dhënave për shkallën, në fushën 206 vendoset fraza e duhur në gjuhën e katalogimit. Në fushën 123 shënohen vlerat e shkallëve.)</i>

7. \*

123	3□	<b>aa b27000 b36000</b>
206	□□	<b>a</b> 1:27.000-1:36.000 ; Hyperboloid proj.

*(Hartë me shkallë të ndryshme. Në fushat 206 dhe 123 shënohet distanca e shkallëve.)*

8. \*

123	1□	<b>aa b1000000</b>
206	□□	<b>a1:1.000.000</b>

*(Hartë me shkallë 1 : 1.000.000. Të dhënat për shkallën në nënfushat 123b dhe 206a duhet të përputhen.)*